



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:188716

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05754059

**C.nr.3150/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale A.Gj. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit A.Ç. me numër personal ..... nga fshati .... Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson av.B.M. nga Prizreni, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 678.59 euro, jashtë seance, me datë 30.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Ç. nga fshati .... Komuna e Prizrenit.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësi të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.09.2019 – 31.12.2019, në shumën prej 45.46 euro;
2. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 31.12.2020, në shumën prej 10.10 euro;
3. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 171.76 euro;
4. Për periudhën kohore 01.01.2022 – 14.09.2022, në shumën prej 370.84 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 598.16 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (14.09.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

**IV. REFUZOHET** e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 678.59 euro, përkatësisht shuma prej 80.43 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

## A r s y e t i m

Paditësi A.Ç. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, në këtë gjykatë me datë 14.09.2022, përmes të autorizuarit të tij A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

Në padi ka theksuar se paditësi ka cilësinë e mësimdhënësit në institucionin arsimore SHFMU “Mid’hat Frashëri” në fshatin Krajë - Prizren dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtresën e datës 02.12.2022, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka bërë precizimin e padisë, ka kërkuar që paditësit t’i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 10.04.2019 e deri me dt. 14.09.2022 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2019 në 2.7%, për vitin 2020 në 0.2%, 2021 në 3.4% dhe për vitin 2022 në 10.4% në pagën e kërkuar prej 421.20 euro e në shumë totale prej 678.59 euro

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 15.12.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit - SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendon paditësja nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu, ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2017 dhe deri në më datë 23.04.2021 parashkruar, sipas nenit 353 të LMD-së, pasi që kanë kaluar mbi 3 vite. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të datës 02.12.2022 si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës nr. protokollit 74/1 për paditësin e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek SHFMU “Mid’hat Frashëri” në fshatin Krajkë - Prizren, si mësimdhënës, që nga data 07.03.2018. Bazuar në Listat e pagave të lësuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se i njëjti ka dy 2 vite përvojë të punës dhe lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.09.2019 - 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 45.46 euro ( $421 * 2.7\% = 11.36 * 4 = 45.46$ )
- Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ( $421 * 0.2\% = 0.84 * 12 = 10.10$ )

- Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është  $171.76$  euro ( $421 * 3.4\% = 14.31 * 12 = 171.76$ )
- Për periudhën 01.01.2022-14.09.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, mirëpo në kërkesën e paditësit është kërkuar në shkallë të inflacionit prej 10.4%, në këtë drejtim gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, “vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, andaj duke pasur parasysh kërkesën e paditësit dhe se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është  $370.84$  euro ( $421 * 10.4\% = 43.8 * 8 = 350.4$ ) si dhe periudha 14 ditë të muajit Shtator është  $20.44$  euro sipas llogaritjes ( $43.8 / 30 = 1.46 * 14$  ditë =  $20.44$  euro). Apo në shumë të përgjithshme prej  $598.16$  euro duke e llogaritur për periudhën 01 Shtator 2019 deri 14 Shtator 2022 ( $45.46 + 10.10 + 171.76 + 370.84 = 598.16$ ).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 14.09.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësi iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 10.04.2019 deri më datë 31.08.2019.

Me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 14.09.2022, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.09.2019 e deri më 14.09.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 14.09.2022, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin Shtator 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin Shtator 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që i njëjti ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimi të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin Shtator 2019 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht Tetor 2019, i njëjti ka mundur të kërkojë përbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që “Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësit kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej  $421.00$  euro, duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësit, e që është shuma prej

424.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditësi në shumën prej 421.20 euro. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësit sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës nga data 10.04.2019 deri më datë 31.08.2019 si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësi në shumë prej 421.20 dhe asaj që paditësi e realizon e që është në shumë prej 421.00 euro, pra shuma e tërësishme e parashkruar dhe pabazuar në lartësi prej 80.43 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (14.09.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara dhe atë lidhur me precizimin e padisë në vlerës prej 104 euro, pasi që gjykata ka njohur shpenzimet për përpilimin e padisë e cila me paraqitjen e në gjykatës duhet të jetë e caktuar dhe e precizuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.3150/2022, të datës 30.05.2024**

**G j y q t a r j a**

**Njomëza Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.